

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje mjetesh motorike me qira operationale për OSSH sh.a dhe FTL sh.a, me afat 3 vjeçar”**

---

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8 – Automjete.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**- 130,805,568 (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) (Monedha), lekë pa TVSH.**

**OSE**

**- 1,330,406.5 (një milion e treqind e tridhjetë mijë e katërqind e gjashtë pikë pesë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 19.06.2025, 1 euro = 98.32 All.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE Group Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsytimit të meposhtem:**

Kjo kontrate nuk është ndare në lote pasi administrimi i saj do të bëhet nga OSHEE Group sh.a, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga qendra, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim.

Objekti i kontratës lidhet me marrjen me qira operationale të mjeteve motorike të cilat kanë karakteristika dhe tiplogji të njejet dhe këto automjete tregohen nga operator ekonomik të cilet ofrojnë të gjitha kategoritë e mjeteve të kërkuara. Përsa me lart ndarja në lote do të nderlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe shpenzime operative shtese dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi dhe vonesa për menaxhimin e mjeteve me të cilat edhe një sërë procesesh të tjera.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....  
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontratës për këtë objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: “*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në*

*kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontratë të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

---

### **2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

Certifikatë ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, **OSE EKUIVALENTE** (e vlefshme, e leshuar nga organizma të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Gjithashtu, kjo certifikatë është e nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë në raport me objektin e kontratës që do të realizohet sipas standarteve ndërkombëtare ISO.

### **2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratat/autorizimet nga prodhuesi/distributor i autorizuar, por në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për mjetet e ofruara.**

**ARGUMENTIM:** *Kontrata/Autorizimi nga Prodhuesi/Distributori kerkohen ne menyre qe AK te sigurohet qe ekziston marredhenia OE-Prodhues/Distributor, gje e cila do te garantoje furnizimin me mallrat e kerkuara, por edhe procesin korrekt te mirembajtjes pergjate zbatimit te saj.*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### **2.3.4 Me qëllim krahasimin e specifikimeve teknike të ofertuara me ato të kërkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun/fragmentin e katalogut të mallrave me të cilat oferton.**

**ARGUMENTIM:** *katalogu/fragment katalogut i mjeteve kerkohet, me qellim krahasimin e specifikimeve te automjeteve me te cilat ofertohe, me specifikimet e autoritetit kontraktor.*

- 2.3.5 Me qellim riparimin e difekteve teknike te mjeteve, (ndërrime pjesësh konsumi si goma, ferrota frena, disqe frenash, fshirëse xhami, amortizator, gomina, etj.), Ofertuesi te provoje se disponon auto servis te cilin duhet t'a kete te pasqyruar ne aktivitetin e vet ne QKR, ose te kete kontrata sherbimi/bashkepunimi te vlefshme.

***ARGUMENTIM:AK duhet te bindet qe gjate kohezgjatjes se kontrates operatori ekonomik ka aftesine dhe kapacitetin per furnizimin e magazinave te tij me te gjitha materialet e nevojshme per sherbimet e mirembajtjes ose perfitimin e sherbimit te servisimit nga operator te trete.***

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate se me dorezimin e mjeteve motorike objekt i procedures se prokurimit detyrimisht do te mbuloje me shpenzimet e tij te gjitha pagesat ne lidhje me institucionet perkatese (dhe ato shitesë) si: Taksa e posedimit, taksa rrugore/qarkullimi, kontrollin fizik dhe teknik te mjeteve dhe cdo shpenzim tjeter qe lidhet me mjetin (taksa lokale apo te pergjithshme, pronesie etj) per te gjithë periudhen e kontrates.

***ARGUMENTIM: Ne kontratat e qirase operationale per mjetet motorike te gjitha shpenzimet qe lidhen me qarkullimin e mjetit ne infrastrukturen rrugore duhet te perballohen nga OE. Keto shpenzime perfshijne edhe pagesat qe certifikojne aftesine teknike te mjetit gjate kohezgjatjes se kontrates.***

- 2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te percaktoje ne oferten nje liste me limitin e km per nderrim te gomave, limitin e km per zevendesimin e amortizatoreve, nderrimin e filtrave dhe vajit te motorit, si edhe te gjitha serviseve periodike te nevojshme per tu kryer ne mjetet e dhena me qera per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates, referuar specifikimeve teknike.

**Ne levrimi i mallit, për t'u siguruar që cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, furnizuesi per mallrat sipas Autorizimit te Prodhuesit ose te distributorit te autorizuar nga prodhuesi duhet te paraqese dokumentacionin sa me poshte:**

- 1.1 Shlyerjen e te gjitha detyrimet ne lidhje me institucionet perkatese (dhe ato shitesë): Taksa e posedimit, taksa rrugore / qarkullimi te vitit perkates. Per kete duhet te paraqese origjinale/ kopje te ketyre dokumentave te noterizuara.

***ARGUMENTIM: Ne kontratat e qirase operationale per mjetet motorike te gjitha shpenzimet qe lidhen me qarkullimin e mjetit ne infrastrukturen rrugore duhet te perballohen nga OE. Keto shpenzime perfshijne edhe pagesat qe certifikojne aftesine teknike te mjetit gjate kohezgjatjes se kontrates.***

- 1.2 Te kete te pajisura te gjitha mjetet me Siguracion te detyrueshëm TPL si edhe Siguracion i Plotë KASKO (mbulim për vjedhje/zjarr/dëme) për gjithë periudhen e Qirasë së Plotë Operacionale. Per kete duhet te paraqese origjinale/kopje te noterizuara te siguracioneve.

**ARGUMENTIM:** Sigurimi i mjeteve motorike per demet ndaj paleve te treat eshte detyrim ligjor te cilin duhet ta plotesojne te gjitha mjetet qe qarkullojne ne territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit". Siguracioni i plote KASKO eshte kerkuar ne menyre qe te minimizojë riskun e demeve qe mund ti shkaktohen mjetit motorik gjate perdorimit te tij nga punonjesit e OSHEE sh.a. ne kontratat e qirave operacionale te mjeteve motorike kostot e sigurimeve te mesiperme jane detyrim i OE.

### 1.3 Certifikatat e origjines te mjeteve.

**ARGUMENTIM:** *kerkohet certifikata e origjines se mjeteve me qellim per te verifikuar origjinen e tyre dhe per tu siguruar mbi prodhuesin e mjeteve.*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, persa i perket ofertes teknike.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

**Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.**